



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3 Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 07.12.2017, nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. **Z. MANUSH SHAMOLLI** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Lipjan, nga subjekti politik “Nisma për Kosovën” duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal **z.Heset Sahiti**.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së , që ky vendim t’i komunikohet **z.Manush Shamollit**, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

### Arsyetim


Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të dorzuara në KQZ më datën 01.12.2017, nr.2405/2017, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit z.Heset Sahiti, pas dorëheqjes së tij të parevokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës.

Andaj, duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatit të radhës sipas listës së rirenditur, i cili është z.Manush Shamolli, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 07.12.2017

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

  
**Valdete Daka**  
Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Prishtinë  
Priština  
CENTRALNA IZBORNA KOMISIJA